

Sektori veprave civile të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas nenit 34 paragrafi 2 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 25.05.2021, miratoi:

## **M E N D I M   J U R I D I K :**

**Me regjistrimin e shënimit të urdhëresës për përmbarim në certifikatën e pasurisë në kadastrën e patundshmërive, mbi patundshmëritë e debitorit të falimentimit para hapjes së procedurës së falimentimit, kreditori nuk fiton cilësinë e kreditorit të veçuar dhe të drejtën e përbushjes së ndarë nga patundshmëria.**

### **A r s y e t i m**

Sipas nenit 128 paragrafi 1 të Ligjit për falimentim, kreditorët të cilët kanë të drejtë të pengut apo të drejtën e përbushjes së ndonjë lënde apo të drejtat të cilat janë të regjistruara në librat publik (në Entin shtetëror të Punëve Gjeodezike, Regjistrin qendror, në regjistrat tjerë përkatës dhe ngjashëm), kanë të drejtën e përbushjes së ndarë të atij sendi ose të drejte sipas ligjit.

Sipas nenit 168 paragrafi 2 të Ligjit për përmbarim, me këtë shënim kreditori e fiton të drejtën që kërkesën e tij ta përbush nga patundshmëria (e drejtë për përbushje) edhe në rast se ndonjë person i tretë më vonë, respektivisht pas shënimit të urdhëresës për përmbarim në patundshmërinë e njëjtë, të fitojë të drejtën e pronësisë ose të drejtën për dispozicion, përveç se në rastet kur do të vijë në realizimin e shënimit me sugjerimin në librin publik në pajtim me dispozitat e Ligjit për kadastrë të patundshmërive.

Në paragrafin 3 të këtij neni është normuar se kreditori i cili ka kërkuar përmbarim, kurse më herët nuk e ka pasur të drejtën e pengut, me shënimin e urdhëresës për përmbarim mbi patundshmëri fiton të drejtën që nga patundshmëria ta përbush kërkesën para personit, i cili më vonë do ta fitojë të drejtën e pengut mbi atë patundshmëri apo të drejtën për përbushje.

Duke u nisur nga përmbytja e dispozitave më sipër të theksuara, të Ligjit për përmbarim rrjedh se kreditori me regjistrimin e shënimeve të urdhëresës për përmbarimin nga patundshmëria e debitorit nuk e fiton të drejtën e pengut mbi këtë patundshmëri, por fiton të drejtën e vetme që kërkesën me para ta përbush nga patundshmëria në rastet kur ndonjë person i tretë më vonë mbi të njëjtën patundshmëri të fitojë të drejtën e pronësisë ose të drejtën e dispozicionit si dhe me të drejtë të përbushet nga patundshmëria para personit i cili më vonë do të fitojë të drejtën e pengut mbi atë patundshmëri ose të drejtën e përbushjes. Në kuptim të kësaj, kreditori nuk ka fituar të drejtën e pengut mbi patundshmërinë e lëndës së debitorit, ashtu që nuk ka të drejtë të ndarë për përbushjen nga patundshmëria sipas nenit 128 të Ligjit për falimentim gjatë situatës kur mbi debitorin është hapur procedurë e falimentimit.

**Gjykata supreme e  
Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Sektori i veprave civile**